



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/205

Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 196, 197, 198, 199, 200 dhe 201 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/205
Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 17/2012 për caktimin e lartësisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.
2. Obligohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/205

Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.
2. Obligohet Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/205

Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë Nr. 02/204 të datës 05.11.2014

1. Pika 2. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/204 të datës 05.11.2014 zëvendësohet me tekstin si në vijim: "2. Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në Këshillin Gjyqësor të Kosovës Kodi 328, Programi 33300 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor, Kategoria ekonomike Mallra dhe shërbime 13000"
2. Pika 3. e këtij Vendimi zëvendësohet me tekstin si në vijim: "3. Obligohet Ministria e Financave dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi"
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/205

Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi dhe krijimi i të drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit cilat preken nga ndërtimi i Linjës Energjetike 400kV Kosovë-Shqipëri, Segmenti II-dytë 32 km, Zonat Kadastrale Çikatovë e Vjeter, Arllat, Domanek, Gllobar, Krajkovë, Llapushnik, Negroc, dhe Çikatovë e Re të Komunës së Drenasit, Zonat Kadastrale Balincë, Vermicë, Shkarashnik, Llashka Drenovc, Carrallukë, Mirushë, Dragobil, Burim dhe Gurbardh të Komunës së Malishevës, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e

shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Kompania Publike "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" Sh.A. (KOSTT) do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/205

Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M P R E L E M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi i përhershëm dhe me krijimin e të drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndertimi i Linjës Energjetike 400kV Kosovë-Shqipëri, Segmenti III-tretë 45 km, Zonat Kadastrale, Pastasellë, Polluzhë, Dubidol, Zatriq, Qifllak dhe Rahovec të Komunës së Rahovecit, Zona Kadastrale Gramaqel, Komuna Deçan, Zona Kadastrale Junik, Komuna Junik dhe Zonat Kadastrale Dubibare, Meqë, Bec, Kodrali, Zhdrellë, Janosh, Palabardh, Novosellë s Epërme, Dobrixhë, Hereq, Sheremet, Nivokaz, Batushë, Molliq dhe Brovinë të Komunës së Gjakovës, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas aprovimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit/MMPH, Ministria e Financave dhe Kompania Publike "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" Sh.A. (KOSTT).
4. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/205

Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 350,000.00 (treqindpesëdhjetë mijë) euro për financimin e nevojave të Universitetit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga nën-programi "Shpenzimet e paparashikuara" me kod 131, kategoria ekonomike Rezerva dhe barten në nën-programin "Universitetin e Prishtinës" me kod 904 në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime.
3. Obligohet Universiteti i Prishtinës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/205
Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Lejohet transferi i mjeteve financiare në Agjencinë Kosovare të Pronës në vlerë 9,490.00 euro nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale (projekti furnizim me fotokopje), kodi i projektit 13556, në kategoritë ekonomike mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale si në vijim:
 - 1.1. Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime transferohen mjete financiare në vlerë prej 5,000.00 euro, dhe
 - 1.2. Kategorinë ekonomike shpenzime komunale transferohen mjete financiare në vlerë prej 4,490.00 euro.
2. Obligohet Agjencia Kosovare e Pronës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/205

Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Lejohet transferi i mjeteve financiare në Ministrinë e Punëve të Brendshme si në vijim:
 - 1.1. Transferohen mjetet financiare në vlerë prej 340,000.00 euro nga nën-programi "Shërbimet e Mbështetjes" (kodi 304), kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale, nga projekti "Automjete transporti " (kodi 30037), në kategorinë Mallëra dhe Shërbime në nën-programin "Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave" (kodi 327), dhe
 - 1.2. Transferohen mjetet financiare në vlerë prej 111,074.00 euro nga nën-programi "Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave" (kodi 327), kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale, nga projekti "Furnizim me pajisje tjera për shërbimet e zjarrëfiksive " kodi 13379, në kategorinë Mallra dhe Shërbime në nën-programin Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave kodi (327).
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/205

Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Prokurorit të Shtetit për buxhet shtesë në vlerë prej 183,000.00 euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga nën-programi "Shpenzimet e paparashikuara" me kod 131, kategoria ekonomike Rezerva dhe barten në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime në nën-programin "33500" Prokuroria dhe Administrata, me kod 250 Organizata Buxhetore, Prokurori i Shtetit.
3. Obligohet Prokurori i Shtetit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/205
Datë: 19.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë Nr. 03/204 të datës 05.11.2014

1. Ndryshohet dhe plotësohet teksti në pikën 1. të Vendimit Nr. 03/204 të datës 05.11.2014 dhe teksti: "e cila do të organizohet më 28 nëntor 2014" zëvendësohet me tekstin: "e cila do të organizohet më 16 janar 2015"
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë